



Thirrje për anketues për realizimin e hulumtimit "Kapitali social tek të rinjtë"

Forumi Arsimor Rinor (MOF) hap thirrje për 10 anketues për periudhën tetor – nëntor. MOF gjatë periudhës maj - dhjetor 2018 realizon hulumtim për kapitalin social te të rinjtë të moshës 16 dhe 29 vjeç. Ky hulumtim ka për qëllim të zbulojë sjelljen e të rinjve në lidhje me angazhimin qytetar dhe aktivizmin, punën vullnetare, sistemin arsimor, besimin në institucionet dhe nivelin e lirisë së shprehjes.

nëpërmjet zbatimit të këtij hulumtimi do të fitohet një pasqyrë për gjendjen aktuale të angazhimit qytetar dhe përfshirjen sociale të studentëve maqedonas gjatë kësaj duket treguar edhe fushat e nevojshme ku nevojitet ky ndryshim.

Për nevojat e këtij hulumtimi, shpallim konkurs për 10 anketues të cilët do të përfshihen drejtpërdrejtë në zbatimin në teren të hulumtimit dhe regjistrimin e të dhënave. Hulumtimi në teren parasheh realizimin e pyetësorëve nëpër universitetet dhe shkollat e mesme në: Shkup, Tetovë, Shtip, Manastir, Ohër, Veles, Strumicë dhe Kumanovë nga 8 tetor deri më 8 nëntor.

Me qëllim grumbullimin përkatës të të dhënave në teren, për anketuesit e zgjedhur do të sigurohet trajnim përkatës ku prezenca do të jetë e detyrueshme. Anketuesit do të angazhohen gjatë muajve tetor dhe nëntor dhe do të punojnë në ekiye përkatëse në çift.

Të gjithë të interesuarit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë të moshës madhore,
- Të kenë motivim të përfshihen në realizimin në teren të hulumtimit,
- Të mund ta realizojnë hulumtimin gjatë orarit të punës,
- Gjatë periudhës nga 8 tetor deri më 8 nëntor të jenë në shtet dhe të mund ta realizojnë anketimin në qytetet e lartpërmendura,
- Përvoja paraprake në anketim do të konsiderohet përparësi,
- Njohja e gjuhës shqipe (për anketuesit në shkolla dhe fakultete të caktuara)
- Të marrin pjesë në trajnimin njëditor më 8 tetor,
- Të kenë shkathtësi të mira komunikimi.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin një letër motivimi të shkurtë (jo më të gjatë se një faqe) dhe CV, më së voni deri më 4 tetor 2018 në policy@mof.org.mk me fjalëkalimin "Paraqitje për anketues". Të gjitha pyetjet në lidhje me këtë thirrje mund ti adresoni në e mail adresën e njëjtë.

Për anketuesit e përzgjedhur të cilët do të jenë të angazhuar një muaj është parashikuar edhe kompensim financiar. Anketuesit e përzgjedhur do të informohen më 5 tetor për kohën dhe lokacionin për mbajtjen e trajnimit njëditor.



Проектот за младинско изразување е спроведуван од Младински образовен форум, Центарот за Балканска соработка - Љоја и Младински сојуз Крушево. Проектот е поддржан од Европската Унија.

